

LIGJ
Nr.7566, datë 25.5.1992
PËR ARMËT

(Ndryshuar me ligjin nr. 7604, datë 10.9.1992; me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 18.09.1992; me ligjin Nr.7809, datë 30.3.1994; nr.7942, datë 31.5.1995; nr. 8011, datë 11.10.1995; nr.10 137, datë 11.5.2009)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Quhen armë në kuptimin e këtij ligji armët e zjarrit të çdo lloji e kalibri (armët luftarake, sportive, gjuetie e speciale dhe të prodhuara e të përshtatura në mënyre artizanale), municionet e tyre, bombat e minat, si dhe armët e ftohta, si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjetet e tjera të përgatitura e të destinuara posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje.

Neni 2

Armët luftarake të zjarrit, sportive dhe të ftohta janë vetëm pronë shtetërore.
Armët e gjuetisë mund të jenë pronë e shtetit ose e personave juridikë e fizikë.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e prodhimit dhe/ose ndreqjes së armëve të zjarrit, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese të këtij ligji. Prodhimi kryhet vetëm nga subjekte ku shteti kontrollon të drejtat pronësore. Ndreqja e armëve mund të bëhet edhe nga subjekte private. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.

Neni 4

Të drejtën për dhënien e armëve luftarake të zjarrit për efektivat e kanë përkatësisht Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Shërbimi Informativ Kombëtar.

Neni 5

Kanë të drejtë të pajisen me armë zjarri nga organet e Rendit Publik personat me detyrë shtetërore e partiake :

a) Deputetët e Kuvendit Popullor, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe personat e tjerë të barazuar me ta, kryetarët e partive politike, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Kasacionit, prokurori i Përgjithshëm e kryetari i Hetuesisë së Përgjithshme dhe zëvendësit e tyre, si dhe drejtuesit e organeve lokale të pushtetit në njësitë bazë administrative

tokësore.

b) Gjyqtarët, përmbaruesit gjyqësorë, prokurorët dhe hetuesit në organet qendrore e në rrethe, sipas kërkesës së tyre.

c) Shoferët e personave që përfshihen në shkronjën "a".

Neni 6

Kur personat e përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji largohen nga detyra ose funksioni, u hiqet e drejta për mbajtejn e armës dhe detyrohen ta dorëzojnë atë në organin përkatës të Rendit Publik, sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Rendit Publik.

Neni 7

(Shtuar shkronja "ç" me ligjin nr. 7604, datë 10.9.1992; shtuar shkronjat "ç", "d" dhe "dh" me ligjin nr. 7809, datë 30.3.1994; shtuar shkronja "e" me ligjin nr. 8011, datë 11.10.1995)

Organet e Rendit Publik japin leje dhe pajisin me armë zjarri:

a) Personat fizikë që caktohen me detyrën e rojes për sigurimin e objekteve të përcaktuara me akt nënligjor të Këshillit të Ministrave.

b) Kryetarët e trenave të mallrave e të udhëtarëve.

c) Kinostudion "Albafilm", Radiotelevizionin Shqiptar, trupat teatrale kombëtare e në rrethe, muzetë kombëtare dhe ato të rretheve e zonave.

ç) Punonjësit e Policisë së Shërbimit Pyjor.

d) Punonjësit e Policisë së Ndërtimit.

dh) Punonjës të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit. Punonjësit që do të pajisen me armë zjarri dhe lloji i armatimit përcaktohen nga Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Rendit Publik.

e) Punonjësit e policisë doganore, të policisë tatimore, si dhe inspektorët e Inspektoratit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave. Punonjësit që do të pajisen me armë zjarri dhe lloji i armatimit përcaktohen nga ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin e Brendshëm.

Neni 8

Armët e zjarrit që përfshihen në nenin 7, shkronja "c" dhe municionet e tyre duhet të jenë të paefektshme, me përjashtim të rasteve që përcaktohen me rregullore të veçantë nga Ministria e Rendit Publik.

Armët e zjarrit që përfshihen në nenin 7, shkronja "a", të jenë armë krahu të gjata.

Personat që përfshihen në nenin 7, shkronja "a", gjatë kohës që mbajnë armë, duhet të kenë një shenjë dalluese të dukshme, të caktuar nga Ministria e Rendit Publik.

Neni 9

(Shtuar togfjalësh me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Personat fizikë që paisen me armë sipas nenit 7 të këtij ligji, duhet të kenë mbushur moshën 22 vjeç, të mos kenë të meta mendore e fizike dhe të mos kenë qenë të dënuar më parë për vepra penale që përbëjnë krime njohin armën dhe përdorimin e saj dhe gëzojnë besueshmëri.

Neni 10

Personi që mban me leje armë të çdo lloji, ka përgjegjësi ligjore për përdorimin e saj

nga të tjerët.

Ndalohet përdorimi i armëve të zjarrit të luftës për gjueti. Qitja me armë zjarri të luftës dhe ato sportive lejohet vetëm në poligonet, ose në vendet e caktuara për këtë qëllim, me masa sigurimi.

Neni 11

(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Ndalohet veprimtaria e paligjshme e dhurimit, këmbimit dhe trafikut të armëve të zjarrit dhe të municioneve të tyre.

Neni 11/1

(Shtuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e prodhimit dhe/ose të tregtimit të armëve të gjahut dhe/ose sportive, pjesëve të tyre dhe/ose i municioneve përkatëse, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë I.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Këto veprimtari licencohen në përputhje me dispozitat vijuese të këtij ligji. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.

5. Në nenin 16, pas fjalës “juridike” shtohen fjalët “si dhe e licencimit të veprimtarive të përcaktuara më sipër në këtë ligj.

Neni 12

Organet e Rendit Publik kanë të drejtë t'i heqin personit armën e zjarrit të çdo lloji, kur ai shkel rregullat për mbajtjen e përdorimin e tyre ose kur paraqet rrezik se mund t'i përdorë si mjet krimi.

Kur hiqet leja për mbajtjen e armës, këto u dorëzohen:

Armët luftarake të zjarrit dhe armët e ftohta organeve të Rendit Publik, armët sportive shtetërore seksioneve të kulturës dhe sporteve të organeve lokale të pushtetit, armët e gjahut u dorëzohen përkatësisht seksioneve të kulturës dhe sporteve dhe shoqatës së gjuetarëve, të cilët, në marrëveshje me pronarin, i shesin për llogari të tij ose asgjësohen, kur ato janë të papërdorshme.

Neni 13

Shkelja e rregullave të përcaktuara në nenet 2, 3, 6, 8, 10, 11 e 12 të këtij ligji, kur nuk formon vepër penale, dënohet për kundërvajtje administrative me gjobë nga 2000 deri në 5000 lekë dhe deri në marrjen e armës, nga shefi i policisë së njësisë administrativo-tokësore.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te kryetari i degës së Rendit Publik, akti i të cilit është i formës së prerë.

Neni 14

(Ndryshuar fjalia e parë dhe shfuqizuar fjalia e dytë e paragrafit të katërt me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 18.09.1992; shfuqizuar paragrafi i pestë i nenit 14 me ligjin nr.7942, datë 31.5.1995)

Nuk ka të drejtë të mbajë armë asnjë person tjetër, përveç atyre të përcaktuar me këtë ligj.

Personat fizikë që e humbasin të drejtën e mbajtjes së armës janë të detyruar t'i dorëzojnë

ato pranë organeve të Rendit Publik.

Personat fizikë që kanë armë pa leje dhe që i dorëzojnë ato vullnetarisht brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përjashtohen nga përgjegjësia penale.

Organet e policisë së rendit lejohen që pa miratimin paraprak të prokurorit të rrethit përkatës, të kryejnë kontrole të personit ose të banesës vetëm në raste flagrante ose kur kanë të dhëna mjaftësisht të bazuara se ai mban pa leje armë, municione apo eksploziv. Menjëherë pas kryerjes së çdo kontrolli të tillë, e gjithësesi jo më vonë se 12 orë nga përfundimi i tij, organet e policisë detyrohen të njoftojnë prokurorin e rrethit përkatës për miratim.

Neni 15

Armët me vlera historike e kulturore, që ruhen në muze, në familje dhe nga persona privatë, vlerësohen si të tilla nga një komision i posaçëm, dokumentohen në një regjistër të veçantë dhe i lihen në zotërim personit pa të drejtën e municioneve për to. Shitja e tyre lejohet vetëm duke ua kaluar muzeve shqiptare ose organeve shtetërore përkatëse.

Neni 16

(Shtuar togfjalësh me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Rregullat e administrimit dhe të kontrollit të armëve për personat fizikë e juridikë si dhe e licencimit të veprimtarive të përcaktuara më sipër në këtë ligj caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 17

Dekreti nr.4279, dt.20.6.1967 "Për armët" si dhe aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.195, datë 29.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**